

VENDIM
Nr.1100, datë 16.12.2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.651, DATË 13.8.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE, SI PASOJË E COVID-19, PËR TË PUNËSUARIT APO ISH-TË PUNËSUARIT NË SUBJEKTET E TRANSPORTIT PUBLIK, QYTETAS DHE NDËRQYTETAS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.651, datë 13.8.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Në kreun I bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Dhënie ndihme financiare prej 10 000 lekësh për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas si dhe aktivitetin taksi."

b) Pas pikës 2 shtohen pikat 2/2 dhe 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/2. E përfitojnë ndihmën financiare sipas pikës 1/1, të këtij kreu, të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet sipas kësaj pike, të cilët kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim, si edhe ata të cilët nuk kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim, me kushtin që të figurojnë në listëpagesat e muajit shtator 2020.

2/3. Përfshihen nga përfitimi i ndihmës financiare:

a) individët e punësuar, të cilët kanë realizuar për vitin 2019 të ardhura bruto nga paga mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë;

b) punonjësit e institucioneve shtetërore;

c) të punësuarit në shoqëritë me kapital shtetëror".

2. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Ndihma financiare llogaritet dhe jepet për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas, që figurojnë në listëpagesat e deklaruara për periudhën tatimore shkurt 2020, të cilat janë dorëzuar pranë administratës tatimore deri në datën 12.8.2020."

b) Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, me këtë përmbajtje:

"1/1. Ndihma financiare, sipas pikës 1/1, të kreut I, llogaritet dhe jepet për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas si dhe aktivitetin taksi, të cilët kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim.

1/2. Për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas, ndërqytetas si dhe aktivitetin taksi, të cilët nuk kanë përfituar nga paketat e mëparshme të ndihmës financiare apo ky vendim, ndihma financiare llogaritet dhe jepet për punonjësit apo ish-punonjësit që figurojnë në listëpagesat e muajit shtator 2020."

c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Aplikimi për të përfituar ndihmën financiare për punonjësit apo ish-punonjësit, të cilët nuk kanë përfituar ndihmë financiare, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.254, datë

27.3.2020, ose nr.305, datë 16.4.2020, bëhet nga vetë individët. Miratimi kryhet pas verifikimit të kriterëve, bazuar në të dhënat që administrata tatimore disponon apo të dhënat që do të dorëzojnë.”.

3. Pika 1, e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Efektet financiare, në masën 245 886 000 (dyqind e dyzet e pesë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, do të përballohen nga fondi i rezervave të krijuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”.

II. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe